



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 466 Prot.

Tiranë, më 3 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 84 , Datë 3 / 4 / 2018

Bazuar në informacionin e marrë me email¹ nga “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” CRCA, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: *“Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”*, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara”* me Urdhrin nr. 194, datë 29.12.2017, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me dhunën e ushtruar ndaj disa fëmijëve në linjën e transportit qytetas të Bashkisë Durrës, në datë 27.12.2017². Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas informacionit të dhënë, “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” CRCA, informon se: *“Më datë 27.12.2017, BalkanWeb raporton pamjet e rënda të një punonjësi faturino, i cili shtyn disa fëmijë të komunitetit rom nga autobusi i linjës së qytetit të Durrësit, duke vënë në rrezik shëndetin e tyre”*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, verifikimin e rastit, marrjen e masave për ndalimin e diskriminimit në linjat e autobusave të qytetit të Durrësit dhe marrjen e masave administrative ndaj personit, kompanisë dhe Bashkisë Durrës.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet*

¹ Email datë 28.12.2017 të dërguar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

² Publikuar fillimisht në portalin JOQ.al dhe BalkanWeb, datë 27.12.2017 “Ndodh në Durrës/ Faturinoja ndalon autobusin dhe hedh në mes të rrugës 3 fëmijët e mitur”.

politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës dhe moshës janë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 12, datë 03.01.2018 është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Bashkinë Durrës në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 37, datë 20.02.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Bashkinë Durrës”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Bashkisë Durrës, më datë 02.03.2018, për të marrë informacion dhe për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit në Bashkinë Durrës, inspektorët e Komisionerit morën takim me Drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike e cila informoi se nevojitej më shumë kohë për të grumbulluar informacion dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale për të dhënë një përgjigje të plotë për identifikimin e linjës së autobusit në të cilën ka ndodhur ngjarja dhe për të kontaktuar me kompaninë dhe pastaj informacionin e marrë do e dërgojnë në rrugë shkresore dhe me email në ditët në vijim.

Me shkresën nr. 3832/2, datë 05.03.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Durrës informon se: *“Ndodhur në kushtet ku nga video e publikuar për këtë rast nuk mund të përcaktohet se në cilën linjë qytetase ka ndodhur ngjarja, Bashkia Durrës i ka drejtuar një shkresë dy operatorëve të transportit publik të cilët operojnë në linjat qytetase të qytetit të Durrësit për ti vënë në dijeni me konstatimet e publikuara si dhe ka kërkuar që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme emergjente në mënyrë që kjo ngjarje të mos përsëritet më”.*\

Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:

Legjislacioni shqiptar përmban bazat ligjore për mbrojtje të veçantë për fëmijët dhe të rinjtë. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54 të saj parashikon se: 1. "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti", 3. "Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal".

Shteti Shqiptar është angazhuar për të respektuar të drejtat e fëmijëve, duke formalizuar vullnetin e vet përmes ratifikimit me anë të ligjit 7531, datë 11.12.1991 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

Kështu në nenin 19/1 të kësaj Konvente parashikohet se: "*Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar*".

Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të racës dhe moshës dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të nenit 3, pika 2 e ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar mbi pamjet filmike dhe informacionit të dhënë nga organizata Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri" CRCA, Komisioneri vlerëson se dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Por, zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përfundim të hetimeve të kryera nuk arriti të identifikonte linjën e transportit publik dhe faturinon i cili kishte kryer veprimin e dhunshëm ndaj fëmijëve.

Për sa më sipër, në mungesë të informacionit zyrtar nga ana e Bashkisë Durrës në lidhje me identifikimin e linjës së transportit publik në të cilën ka ndodhur ngjarja si dhe në kushtet e

mosidentifikimit të subjektit që ka kryer veprimin diskriminues, në mbështetje të nenit 95, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *Pamundësia në objekt apo qëllim: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 32, pika 1, gërma a) si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes lidhur me dhunën e ushtruar ndaj disa fëmijëve në linjën e transportit qytetas të qytetit të Durrësit, në datë 27.12.2017, për shkak të pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm për shqyrtimin e kësaj ankese.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI